



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

06-351-38214/23

Klinë, data: 07.11.2023

Për: Qytetarët, Persona Juridik, Biznese, OJQ e Grupe Tjera të Interesit të Komunës së Klinës

Lokacioni: Ndërtesa e Kuvendit Komunal Klinë

Data: 17.11.2023

Koha: 14:00

**FTESË PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PROFILIN
KOMUNAL DHE VLERËSIMIN E GJENDJES EKZISTUESE TË PLANIT ZHVILLIMOR
KOMUNAL TË KLINËS 2023-2031**

Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) në bashkëpunim me O.Sh. Kolegji "UBT" nga Prishtina, ka kënaqësinë t'ju ftojë në diskutimin publik lidhur me Profilin Komunal dhe Vlerësimin e Gjendjes Ekzistuese të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës 2023-2031.

DUMM kërkon pjesëmarrjen tuaj aktive dhe të zëshme, që të jeni të informuar mbi përpjekjet e Komunës për të përgatitur Planin Zhvillimor Komunal të Klinës 2023-2031. Pjesëmarrja juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke paraqitur propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja për të kontribuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e jetës të secilit qytetar të komunës sonë.

DUMM është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara për përgatitjen e një Plani Zhvillimor Komunal të qëndrueshëm për komunën tonë dhe pronat tuaja.



Drejtori i DUMM-it,

Enver Berisha